



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku me Bashkëpunëtoren Profesionale Yllka Pajaziti Abdullahu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Erst Bau Sh.p.k. me NUI ... me seli në Suharekë, Rr. ... p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat A.H. me seli të zyrës në Prizren, kundër debitorit Komuna e Malishevës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të datës 14.12.2022, ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1466/22 të datës 02.12.2022 të nxjerrur nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani me seli të zyrës në Prizren, jashtë seancës me datë 12.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET I BAZUAR prapësimi i debitorit Komuna e Malishevës dt. 14.12.2022, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1466/22 të datës 02.12.2022, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani me seli të zyrës në Prizren.
- II. SHFUQIZOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.1466/22 të datës 02.12.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani me seli të zyrës në Prizren.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.1466/22 të datës 02.12.2022 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm / faturës nr. 19102022-1 e datës 21.10.2022 për shumën e borxhit të papaguar në lartësi 13'002.07€ (trembëdhjetë mijë e dy euro e shtatë cent) nga debitori i çështjes, me kamatëvonesë 8 % nën kërcënim të përmbartimit me dhunë, përfshirë kërkesën për të gjitha shpenzimet e shkaktuara në procedurë.

Debitori i çështjes / konkretisht përfaqësuesi i autorizuar i Komunës së Malishevës, brenda afatit ligjor, ka parashtruar prapësim kundër urdhrin përmbartimor si në këtë çështje. Në prapësimin e paraqitur debitori i çështjes ka theksuar se e kundërshton në tërësi urdhrin përmbartimor për shkak se dokumenti i besueshëm mbi bazën e të cilat i është lejuar nxjerrja e urdhrin përmbartimor / fatura si ën hyrje të arsytimit nuk është pranuar fare nga zyrtari për menaxhimin e kontratës në Komunën e Malishevës, dhe se kontratën në fjalë për çka është lëshuar fatura e ka financuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MPMH) në marrëveshje me Komunën. Kjo marrëveshje me nr. 86 dhe nr. protokollit 134 datë 09.11.2018 ka qenë e paraparë për financim në vlerë 300'000.00€ nga MPMH dhe 23'884.63€ nga Komuna – kushte këto të përcaktuara ën nenin 20.1 të Kontratës. Debitori ka paraqitur në cilësi të provës një kopje të kësaj kontrate.

Tutje i njëjti ka theksuar se borxhi i cili është lëshuar me këtë faturë, është nënshkruar vetëm nga ana e kreditorit andaj edhe nuk i plotëson kushtet nga neni 29 i LPP-së për ekzekutim. Më tej debitori ka theksuar se projekti nga kontrata e lartëcekur është ndërprerë për shkak të pengesave nga disa pronarë privat, dhe meqë nuk ka akoma një pranim teknik për përfundim të punëve, nuk ka as obligim të mbetur nga Komuna ndaj Kreditorit të çështjes.

Meqenëse në këtë çështje të kontratës e udhëhequr nga Ligji për prokurimin publik të Kosovës, nuk është lidhur ankesë kontratë por ka mbetur pa u realizuar kontrata, Debitori i çështje nga sa u tha më lartë i ka propozuar gjykatës që të aprovohet i bazuar prapësimi i tij, të shfuqizojë urdhrin përbarimor dhe të anulohen veprimet e ndërmarra nga përbaruesi pasi që fatura nuk është e bazuar në nenin 29 të LPP-së.

Kreditori i çështjes ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën ka theksuar se debitori me prapësimin e tij në asnjë rrethanë nuk i ka përmbushur kushtet nga neni 71 i LPP-së për tu shfuqizuar urdhri përbarimor, dhe asnjë pretendim të tij nuk e ka mbështetur në prova siç përcaktohet në nenin 69 par. 4 të LPP-së. Ka shtuar se theksimet e debitorit janë boshe pasi që fatura është paraqitur në origjinal, është nënshkruar dhe protokolluar nga debitori ndërkaq raporti zyrtar i organit mbikëqyrës që ka pranuar kryerjen e punimeve është lëshuar me datën 20.10.2022. Për këto kreditori ka paraqitur dëshmi mbështetëse / raportet përkatëse dhe meqë fatura si dokument i besueshëm i plotëson kushtet nga neni 27.1, 29.1.3 29.3 të LPP-së si dhe në bazë të nenit 30, 40 dhe 43 të LPP-së i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pabazuar në tërësi.

Kreditori ka kërkuar si shtesë edhe kompensimin e shpenzimeve në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumën 416.00€ (katërqind e gjashtëmbëshjetë euro), si dhe të gjitha shpenzimet tjera eventuale që do të shkaktohen deri në përfundim të kësaj procedure.

Gjykata duke marrë për bazë pretendimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe me kusht të vlerësimit të përmbajtjes së dokumentacionit shkresor, së pari trajtoi afatshmërinë e prapësimin të debitorit, nga e cila sipas shërbimit postar të Kosovës / fletëkthesat që gjenden në shkresat e lëndës konstatohet se debitori e ka pranuar urdhrin përbarimor në datën 09.12.2022 ndërkaq prapësimin ka dorëzuar me postë në datën 14.12.2022. Si rrjedhojë e dorëzimit të rregullt, Gjykata konstaton se Debitori i çështjes e kishte dorëzuar prapësimin ndaj urdhrin përbarimor brenda afatit ligjor 7 ditor.

Pas konstatimit të rregullsisë së afatshmërisë së prapësimin, gjykata vlerësoi të njëjtin në përmbajtje dhe gjeti se ky prapësim duhet aprovuar në tërësi si i bazuar konform me dispozitën nga nenin 69 lidhur me nenin 71 par. 1.1 të LPP-së, për shkak se dokumenti i besueshëm / Fatura nr. 19102022-1 e datës 21.10.2022 për shumën e borxhit të papaguar në lartësi 13'002.07€, nuk është e përshtatshme për përbarim ndaj Debitorit.

Vlerësimin e përshtatshmërisë që gjykata i bëri dokumentit të besueshëm si më lartë, e kreu në bazë të dispozitave ligjore të LPP-së si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata ka vlerësuar faturën e Kreditorit nr. 19102022-1 konform me dispozitat e lartpërmendura dhe njëjta është lëshuar për Debitorin Komuna e Malishevës mirëpo pranimi i rregullt i saj nuk është kryer nga Debitori por nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Këtë fakt gjykata e vërtetoi me vulën e protokollit institucional të ministrisë në fjalë e cila i ka dhënë nr. regjistrimit 611/22 datë 21.10.2022.

Meqenëse në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se Debitori Komuna e Malishevës nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën si dokument i besueshëm, por se të njëjtën e ka pranuar një institucion tjetër, dhe nuk ka dëshmi që kjo faturë i është përcjellë Debitorit me kohë, Gjykata konstaton se nga gjendja faktike shkresore e paraqitur nuk mund të llogaritet maturiteti i kërkesës së kreditorit. Andaj edhe konform me dispozitat ligjore të elaboruara si më lartë, ndërlidhur me nenin 71 par. 1 të LPP-së, gjykata vlerëson se dokumentit të besueshëm si në këtë çështje i mungojnë tiparet e përmbarueshmërisë, për çka vendosi që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar në tërësi (si në dispozitiv të këtij aktvendimi), pa pasur nevojë që të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve tjera të çështjes.

Lidhur me prapësimin e debitorit gjykata e ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, ne kuptim të dispozitës nga neni 73 i LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.10/2023, datë 12.06.2023

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.